

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR ADMINISTRIMIN E NËNZONAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE PEIZAZHIT KULTUROR, PJESË E PARKUT KOMBËTAR TË BUTRINTIT, LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË KULTURËS DHE FONDACIONIT PËR MENAXHIMIN E BUTRINTIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i përgatitjes së këtij projektligji është miratimi i marrëveshjes së administrimit ndërmjet fondacionit të posaçëm dhe ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në përputhje me pikën 5, të nenit 172, të ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, në të cilin parashikohet se “Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore lidh marrëveshje me fondacionet e posaçme të trashëgimisë kulturore për administrimin, sipas këtij neni. Kjo marrëveshje i nënshtrohet miratimit nga ana e Këshillit të Ministrave, në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi kombëtare dhe lokale, dhe miratimit të saj në Kuvend, në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi universale, sipas parashikimeve të këtij ligji. Marrëveshja përcakton, ndër të tjera, afatin, tarifat e kushtet e veçanta për administrimin e pasurisë kulturore. Në kryerjen e funksioneve të mbrojtjes, të ruajtjes, të restaurimit, të vlerësimit e administrimit të pasurisë, subjektet zbatojnë parimet dhe detyrimet e parashikuara në këtë ligj dhe nuk u nënshtrohen rregullave të prokurimit publik.”.

Marrëveshja e administrimit të pasurisë kulturore të nënzonës së trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të Parkut Kombëtar të Butrintit është nënshkruar më 16.11.2021, ndërmjet Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit dhe Ministrisë së Kulturës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e parkut kombëtar të Butrintit, lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit” është hartuar nga Ministria e Kulturës, me mbështetjen e studios

ligjore “Tashko Pustina”, sipas kontratës së sponsorizimit nr.3216 prot., datë 27.8.2020.

Ky projektligj është parashikuar në planin e përgjithshëm analitik të akteve të miratuara me vendimin nr.1121, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Modeli i administrimit të nënzonës së trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të parkut kombëtar të Butrintit, i parashikuar nga marrëveshja e administrimit nëpërmjet administrimit tërthorazi përmes krijimit të një fondacioni të dedikuar, erdhi si një nevojë për gjetjen e mënyrave të reja të administrimit, pasi sistemi aktual i menaxhimit, edhe pse ka siguruar i sforcuar mbrojtjen e vlerave kulturore të parkut kombëtar të Butrintit, nuk ishte fleksibël, duke mos garantuar në perspektivë mbrojtjen e ruajtjen e vlerave kulturore dhe natyrore të sitit dhe zhvillimin e integruar të tij, si dhe duke siguruar të ardhura jo me pritshmëritë që duhet të ketë një pasuri me vlera kaq të rëndësishme kombëtare e universale.

Për këtë qëllim, marrëveshja e administrimit është bazuar jo vetëm në ligjin nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, por edhe duke analizuar modele alternative menaxhimi nga përvoja më të mira ndërkombëtare nga Mbretëria e Bashkuar, SHBA-ja, Gjeorgjia, Italia, Franca, Turqia, të cilat mund të aplikohen edhe në rastin e Butrintit.

Kjo mënyrë administrimi nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, sikurse është parashikuar në marrëveshjen e administrimit, do të sigurojë:

- menaxhim të integruar të pasurisë kulturore dhe natyrore të nënzonës së trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të parkut kombëtar të Butrintit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të një qendre, njëherësh pasuri botërore e UNESCO-s dhe sit RAMSAR;
- lehtësira, fleksibilitet dhe avantazhe në mbledhjen e fondeve, shfrytëzim të financimeve nga burime të ndryshme, rritje të të ardhurave nëpërmjet aktivitetit tregtar, sponsorizimit, angazhimeve të palëve të treta;
- ekspertizë të kualifikuar menaxhimi, kërkimi, konservimi, marketingu etj., në përputhje me standardet dhe nevojat bashkëkohore;
- strukturë menaxhimi në sit më të madhe në numër e të kualifikuar për fushat e nevojshme të ekspertizës dhe të menaxhimit;
- zhvillim të qëndrueshëm për të gjithë parkun kombëtar të Butrintit dhe avantazhe ekonomike për komunitetin lokal nëpërmjet rritjes së fondeve, investimeve në përmirësimin e infrastrukturës turistike, zhvillimin e kapaciteteve lokale dhe rritjes së punësimit në park.

Për sa më sipër, administrimi nëpërmjet kësaj marrëveshjeje administrimi, në terma ekonomiko-financiarë dhe efektiviteti, synon zhvillimin e qëndrueshëm për të gjithë parkun kombëtar të Butrintit dhe komunitetin përreth. Ky model administrimi do të bëjë të mundur realizimin e ndërhyrjeve për adresimin e sfidave në menaxhimin e zonës me vlera të trashëgimisë kulturore të Butrintit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj del në bazë dhe për zbatim të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të pikës 5, të nenit 172, të ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Po kështu, projektligj propozohet në vijim të fillimit të zbatimit të planit të menaxhimit të miratuar me vendimin nr.583, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të menaxhimit të integruar të parkut kombëtar të Butrintit”, dhe planin e biznesit të tij.

Pika 5, e nenit 172, parashikon se: “Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore lidh marrëveshje me fondacionet e posaçme të trashëgimisë kulturore për administrimin, sipas këtij neni. Kjo marrëveshje i nënshtrohet miratimit nga ana e Këshillit të Ministrave në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi kombëtare dhe lokale, dhe miratimit të saj në Kuvend, në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi universale, sipas parashikimeve të këtij ligji. Marrëveshja përcakton, ndër të tjera, afatin, tarifat dhe kushtet e veçanta për administrimin e pasurisë kulturore. Në kryerjen e funksioneve të mbrojtjes, ruajtjes, restaurimit, vlerësimit e administrimit të pasurisë, subjektet zbatojnë parimet dhe detyrimet e parashikuara në këtë ligj dhe nuk u nënshtrohen rregullave të prokurimit publik.”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Marrëveshja e nënshkruar për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e parkut kombëtar të Butrintit, lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, është bazuar në nenin 172 të ligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, në

vendimin nr.625, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit”, në udhëzimin nr.583, datë 14.10.2019, të ministrit të Kulturës “Për miratimin e kritereve dhe procedurave standarde të kalimit të pronës në administrim”.

Në bazë të nenit 172 të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, marrëveshja lidhet ndërmjet fondacionit të posaçëm për menaxhimin e Butrintit dhe ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në cilësinë e përfaqësuesit të pronarit shtet.

Përzgjedhja e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim është bërë në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzimin nr.583, datë 14.10.2019, të ministrit të Kulturës, “Për miratimin e kritereve dhe procedurave standarde të kalimit të pronës në administrim”, dhe është vendosur me vendimin nr.3, datë 6.4.2020, të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore.

Në përputhje me kërkesat e nenit 172 të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, ndërmjet ministrisë përgjegjëse dhe trashëgiminë kulturore dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit për krijimin e fondacionit të posaçëm për menaxhimin e Butrintit. Fondacioni është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.858, datë 21.7.2021, në përputhje me kërkesat e ligjit për organizimin dhe funksionimin e organizatave jofitimprurëse.

Lidhja e marrëveshjes së administrimit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, ka si qëllim administrimin efektiv, sipas një modeli administrimi, i cili synon konservimin, mbrojtjen dhe rritjen e vlerave të trashëgimisë kulturore të nënzonës së trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të parkut kombëtar të Butrintit.

Marrëveshja lidhet për një afat 10-vjeçar me të drejtë rinovimi, në bazë të negociatave që palët do të zhvillojnë. Forma e administrimit indirekt e adoptuar nga ligji për trashëgiminë kulturore dhe muzetë është sipas modelit italian të administrimit të pasurive kulturore. Në bazë të këtyre modeleve rezulton se kalimi në administrim bëhet në favor të organizatave jofitimprurëse të krijuara nga institucionet shtetërore ose në bashkëpunim ndërmjet këtyre të fundit dhe organizatave jofitimprurëse, kryesisht fondacione. Kohëzgjatja e kalimit në administrim përcaktohet në varësi të llojit të pasurisë kulturore, funksioneve që i kalojnë fondacionit dhe pjesmarrjes ose jo të shtetit në fondacion.

Nënzona e trashëgimisë dhe e peizazhit kulturor të parkut kombëtar të Butrintit është pasuri kulturore arkeologjike me rëndësi universale, e cila përfshin në

tërësinë e saj një shumëllojshmëri kategorish të pasurive kulturore për zhvillimin e një sërë aktiviteteve kulturore dhe tregtare. Duke marrë në konsideratë shumëllojshmërinë dhe hapësirën e madhe që ka ky sit, administrimi efektiv i kësaj pasurie mund të bëhet vetëm për një kohëzgjatje të tillë, që të mund të lejojë përmbushjen me efektivitet të funksioneve të caktuara, realizimin tërësor të planit të biznesit dhe të projekteve rehabilituese.

Duke marrë në konsideratë rrethin shumë të gjërë të funksioneve dhe tagrave që i kalohen Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, i cili përfshin pjesën më të madhe të detyrimeve dhe të përgjegjësisë për ruajtjen e menaxhimin e sitit, pjesëmarrjen e ministrisë në menaxhimin e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, përmbushja me efektivitet të funksioneve të caktuara mund të arrihet vetëm nëpërmjet një kohëzgjatjeje minimalisht 10-vjeçare. Kohëzgjatja 10-vjeçare përputhet edhe me kontrata të ngjashme sipas modelit italian, të cilat janë mbajtur në konsideratë në dakordësimin e këtij afati.

Marrëveshja përbëhet nga 37 nene dhe 6 shtojca, përmbajtja e të cilave është përcaktuar duke marrë në konsideratë legjislacionin civil lidhur me kalimin e së drejtës së posedimit, përdorimit e gëzimit të pasurive të paluajtshme, specifikat e ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë për pasuritë kulturore, si dhe karakteristikat e pasurisë arkeologjike të parkut kombëtar Butrint. Kjo marrëveshje synon të krijojë një kornizë kontraktore të ekuilibruar midis nevojës së Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit për autonomi në administrimin e nënzonës së trashëgimisë dhe peizazhit kulturor dhe rolit mbikqyrës të Ministrisë për të siguruar mosçenimin e pasurisë kulturore dhe zhvillimin e saj sipas marrëveshjes.

Në bazë të marrëveshjes së administrimit, janë përcaktuar rregullat për kalimin në administrim të pasurisë kulturore, e cila përfshin të drejtën e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit për përdorimin, shfrytëzimin, promovimin, të drejtën për të caktuar e mbledhur tarifën, çmimin e biletave, dhënien në përdorim në të gjitha format, në kuptim të Kodit Civil dhe/ose të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë, e Pasurisë Kulturore, si dhe detyrimet, përfshirë, por pa u kufizuar, mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e pasurisë kulturore, në përputhje me ligjin për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, planin e menaxhimit dhe këtë marrëveshje.

Në përcaktimet e mësipërme të së drejtës së administrimit është marrë në konsideratë kuadri ligjor në fuqi për përdorimin e gëzimin e sendeve, i cili përfshin të gjitha format e këtyre tagrave në bazë të Kodit Civil, si dhe format e posaçme të parashikuara në bazë të legjislacionit të posaçëm, ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.

Përfshirja në të drejtën e administrimit të një sfere kaq të gjerë të kompetencave ka për qëllim realizimin e modelit të administrimit, që është propozuar nëpërmjet letrës për shprehje interesi dhe planit të biznesit të propozuar nga partneri strategjik.

Marrëveshja përfshin dispozita mbi të drejtat reale, që i kalohen Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, garancitë që ofron ministria, në cilësinë e pronarit shtet, si dhe të drejtat mbi pasuritë e luajtshme, që kalohen së bashku pasurinë e paluajtshme. Në këtë aspekt, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit i kalojnë e drejta e posedimit, përdorimit, shfrytëzimit dhe gëzimit të pasurisë së paluajtshme, por jo pronësia e saj, e cila, në çdo rast, i mbetet shtetit.

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit detyrohet të administrojë pasurinë kulturore, në përputhje me destinacionin e saj. Ai detyrohet të respektojë klasifikimin e saj si pasuri kulturore, ndër të tjera, edhe nëpërmjet kryerjes së ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, sipas parashikimeve në plan menaxhimi dhe marrëveshjeje.

Përsa u përket parashikimeve të ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, janë përfshirë parashikime për format e kushtet e ruajtjes dhe të mbrojtjes, format e përdorimit, ruajtja fizike, hyrja dhe shërbimet ndaj publikut, promovimi, hulumtimet arkeologjike, parashikimet lidhur me ndërtimin e qendrës së vizitorëve, studimet dhe analizat që do kryhen, si dhe krijimi i grupit shkencor të Butrintit.

Në kuadër të së drejtës së gëzimit, janë përfshirë përcaktime lidhur me tarifat e çmimet e biletave, duke përcaktuar se “Në përputhje me ligjin për trashëgiminë kulturore dhe muzetë dhe vendimin nr.625, datë 4.9.2019, “Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit”, fondacioni ka të drejtën e përcaktimit e të arkëtimit të tarifave për hyrjen e publikut në pasurinë kulturore sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje. Tarifat për hyrjen e publikut në pasurinë kulturore përcaktohen nga fondacioni, duke respektuar një çmim mesatar të biletës së hyrjes të të gjitha kategorive të vizitorëve, nga 7 deri në 11 USD për të gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes. Çmimi mesatar i biletës së hyrjes në pasurinë kulturore i caktuar më sipër është 75% e çmimit të biletës standarde të hyrjes për të rriturit. Fondacioni ka të drejtën të indeksojë vlerën e çmimit mesatar të biletës së hyrjes në pasurinë kulturore të përcaktuar në këtë nen sipas normës së inflacionit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë dhe ta rrisë atë deri në 30% të vlerës së indeksuar.”.

Kalimi efektiv në administrim të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit është rregulluar në dy faza. Faza e parë lidhet me hyrjen në fuqi të marrëveshjes dhe faza e dytë, periudha tranzitore.

Faza e hyrjes në fuqi lidhet me përmbushjen e kushteve paraprake, që janë miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e e sipërfaqes dhe koordinatave të sakta të nënzonës së trashëgimisë dhe peizazhit kulturor në parkun kombëtar të Butrintit dhe miratimin e marrëveshjes në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e neneve 10 e 172, të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë. Kushtet e mëposhtme janë kumulative, që do të thotë se hyrja në fuqi e marrëveshjes është e lidhur me plotësimin e të dyja kushteve dhe mosplotësimi, qoftë dhe i njërit prej tyre, pengon hyrjen në fuqi të saj.

Periudha tranzitore është faza nga hyrja në fuqi e marrëveshjes në marrjen në dorëzim nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit. Marrja në dorëzim do të konkretizohet me nënshkrimin nga të dyja palët të deklaratës së transferimit, pasi të kenë përmbushur të dyja palët kushtet e transferimit, sipas nenit 6 të kontratës. Kalimi në administrimin në dy faza lidhet përveçse me detyrimet e sanksionuara në ligjin për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, por edhe duke marrë në konsideratë karakterin universal të Butrintit, kohën që u duhet të dyja palëve, respektivisht Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit dhe ministrisë për të përgatitur strukturat e për të përmbushur detyrimet ligjore kundrejt personave të tretë për marrjen në dorëzim të pasurisë.

Parashikime të posaçme janë përcaktuar nga palët lidhur me financimin e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit. Përcaktimet për financimin e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit janë përfshirë në mënyrë të detajuar në marrëveshjen e administrimit, duke marrë në konsideratë që, bazuar në marrëveshjen e administrimit dhe në nenin 172 të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, funksionimi efektiv i Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit lidhet drejtpërdrejt me momentin e kalimit në administrim të pasurisë.

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të financohet fillimisht nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) dhe nga fondet e papërdorura dhe të mbartura të administruara/kontabilizuara nga Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit deri në datën e transferimit të pasurisë kulturore, në përputhje me marrëveshjen e administrimit dhe marrëveshjen e bashkëpunimit. Vlera e financimit nëpërmjet grantit të AADF-së do të jetë deri në vlerën katër milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë dollarë (4,985,000 \$), ndërsa vlera e saktë e fondeve të papërdorura dhe të mbartura të administruara/kontabilizuara nga Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit do të përcaktohet në datën e transferimit.

Disbursimi nga të dyja palët fillon pas transferimit të pasurisë kulturore në datën e transferimit, në vlera ekuivalente, dhe pjesa e mbetur do të disbursohet në vijim të kërkesave për fonde të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, bazuar në nevojat e tij dhe në përputhje me planin e biznesit. Financimi nga ana e AADF-së mund të fillojë edhe më përpara, gjatë fazës tranzitore, në bazë të kërkesave të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, vlerë kjo e cila do të zbritet nga shumat, që do të disbursohen në bazë të marrëveshjes së grantit të lidhur ndërmjet Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit dhe AADF-së.

Financimet si më sipër i kalohen Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, duke pasur si destinacion të vetëm administrimin e pasurisë kulturore. Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, i organizuar si një organizatë jofitimprurëse, do të përdorë të ardhurat vjetore që rezultojnë nga administrimi i pasurisë kulturore vetëm për mirëmbajten, ruajtjen e zhvillimin e pasurisë kulturore. Për më tepër, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të kontribuojë çdo vit në Fondin Kombëtar për Kujdesin e Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mënyrë progresive, duke arritur deri në 2% të të gjithë të ardhurave vjetore të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit nga viti i katërt i marrëveshjes dhe deri në fund të afatit të saj. Fondet financiare të mbledhura nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit dhe të papërdorura deri në përfundim të marrëveshjes do t'i kalojnë ministrisë ose autoritetit publik përkatës, që do të përcaktohet nga ministria.

Një nga elementet kyçe të parashikuara nga marrëveshja e administrimit është ndërtimi i një qendre të re vizitorësh, e cila do të jetë gjithashtu shpenzimi më i lartë kapital që do të kryejë Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit gjatë afatit të marrëveshjes¹. Paralelisht me ndërtimin e qendrës së vizitorëve nga ana e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, marrëveshja parashikon gjithashtu ndërtimin e infrastrukturës mbështetëse, ku përfshihet sistemimi i ujërave të bardha dhe të zeza, rrjeti elektrik dhe linjat rezervë, që mund të jenë të nevojshme për mirëfunksionimin e qendrës së vizitorëve. Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse do të kryhet me fonde të buxhetit të shtetit nga entet përkatëse. Gjithashtu, ministria, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, do të marrë masat e nevojshme për devijimin e trafikut rrugor dhe mbylljen e segmentit përkatës të rrugës kombëtare nga qendra e vizitorëve të hyrja në sit.

Në kuadër të ndërtimit të qendrës së vizitorëve dhe administrimit të pasurisë kulturore, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit është i detyruar të aplikojë për licencat dhe lejet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi. Nga ana e saj, ministria merr përsipër të trajtojë me prioritet licencat dhe lejet që varen nga vetë ministria,

¹ Sipas planit të biznesit, bashkëlidhur marrëveshjes së administrimit, kostoja e përafërt e qendrës së vizitorëve do të jetë 2.6 milionë dollarë.

ndërsa për lejet dhe licencat, të cilat janë përgjegjësi e institucioneve të tjera shtetërore, ministria do të bashkëpunojë në nivel insitucional për të mundësuar marrjen e tyre, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Marrëveshja e administrimit pasqyron të drejtën e ministrisë për të mbikëqyrur mbarëvajtjen e administrimit dhe të aktiviteteve, që do të kryhen nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit. Në përputhje me nenin 12 të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë dhe në përputhje me udhëzimin për rregullat e monitorimit të subjekteve, që kanë në administrim pasuritë kulturore, në marrëveshje janë parashikuar rregullat për vlerësimin e monitorimin e pasurisë kulturore nga ana e ministrisë në cilësinë e pronarit shtet. Rrjedhimisht, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes së administrimit, do të kryejë çdo muaj qershor një raportim vjetor të njësia e monitorimit e ngritur nga ministria lidhur me shërbimet që ofrohen, numrin e vizitorëve, gjendjen e pasurisë, të ardhurat vjetore, planin e biznesit të miratuar, si dhe realizimin e objektivave të parashikuara në lidhje me parkun kombëtar të Butrintit. Gjithashtu, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit ka detyrimin e raportimit nëpërmjet raporteve progresive për ndërtimin e qendrës së vizitorëve.

Në përputhje me ligjin për trashëgiminë kulturore dhe muzetë dhe me vendimin nr.625, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit”, ministria do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në mirëadministrimin e pasurisë kulturore:

- i. duke mbështetur Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit në ushtrimin e funksioneve të ruajtjes e të mbrojtjes dhe duke shërbyer si garant i ruajtjes së vlerave kulturore së sitit;
- ii. duke garantuar bashkëpunimin me autoritetet kompetente në kuadër të marrjes së licencave dhe lejeve, me autoritetet kompetente ligjzbatuese, në kuadër të ruajtjes së rendit publik dhe ofrimit të shërbimeve të tjera të emergjencës;
- iii. duke marrë masat e nevojshme me synim menaxhimin e çdo rreziku të identifikuar në planin e menaxhimit;
- iv. duke kryer, përgjithësisht, çdo detyrë ose funksion të parashikuar në ligjin për trashëgiminë kulturore dhe muzetë dhe në vendimin nr.625, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit”.

Për sa u përket funksioneve të ruajtjes e të mbrojtjes së pasurisë kulturore, veçanërisht:

- i. në rastin e ngjarjes së forcës madhore;
- ii. në rastin e gjetjeve me qëllim katalogimin e kategorizimin e objekteve të pasurisë kulturore; dhe
- iii. kur Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit është në pamundësi për të garantuar mbrojtjen e saj,

ministria merr masa dhe ndërhyr për ruajtjen e mbrojtjen e pasurisë kulturore dhe mund të ndalojë gjithashtu çdo zhvillim apo veprimtari brenda dhe jashtë territorit të saj, që mund të gjykohet se cenon integritetin e pasurisë kulturore.

E drejta e ndërhyrjes së ministrisë përshkallëzohet më tej kur vihet në rrezik ruajtja e pasurisë kulturore si pasojë e:

- braktisjes së pasurisë kulturore nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit;
- ngjarjeve që çenojnë sigurinë kombëtare; ose
- ngjarjes së forcës madhore kur ndërhyrja e Ministrisë është e nevojshme për ruajtjen e integritetit të pasurisë kulturore.

Në këto raste, ministria ka të drejtën e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë në administrimin e pasurisë kulturore pasi të ketë njoftuar paraprakisht Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit lidhur me arsyet e ndërhyrjes dhe natyrën e veprimeve që do të ndërmerren.

Në kuadër të mirëadministrimit të pasurisë kulturore dhe realizimit sa më eficient të objektivave të marrëveshjes së administrimit, Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit i jepet e drejta e kontraktimit të personave të tretë për kryerjen e punëve/shërbimeve specifike.

Neni 26 i marrëveshjes së administrimit parashikon se kjo formë kontraktimi e punëve/shërbimeve mund të kryhet vetëm në rastin kur palët e nënkontraktuara zotërojnë kualifikimet dhe eksperiencën përkatëse për kryerjen e detyrave. Në çdo rast, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit nuk mund t'ua kalojë të gjitha të drejtat e administrimit të pasurisë kulturore palëve të treta dhe përgjegjësia ndaj nënkontraktorëve i takon vetëm Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit e, në asnjë moment, ministria nuk do të jetë përgjegjëse për pretendime ose dëmshpërblime që kanë ardhur si rrjedhojë e marrëdhënies kontraktore ndërmjet Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit dhe palëve të treta.

Me mbarimin e afatit ose të zgjidhjes së parakohshme të saj, marrëveshja e administrimit parashikon një dorëzim të strukturuar të pasurisë kulturore nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit te Ministria, sipas një kalendari dorëzimi të detajuar.

Modeli i administrimit të pasurisë kulturore nga një fondacion i posaçëm, sikurse parashikohet nga marrëveshja e administrimit, bëhet mbi baza jofitimprurëse. Rrjedhimisht, çdo aset ose aktiv, që do të jetë krijuar gjatë administrimit të pasurisë kulturore nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, përfshirë fonde financiare, pronësi intelektuale, materiale kërkimore, pasuri të paluajtshme (si qendra e vizitorëve), pasuri të luajtshme (autobusë elektrikë), infrastrukturë mbështetëse brenda pasurisë kulturore, si dhe vetë pasuria kulturore, do t'i dorëzohen ministrisë me mbarimin e afatit të marrëveshjes së administrimit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ministria e Kulturës është institucioni kryesor shtetëror, i cili ka për detyrë zbatimin e këtij ligji. Më pas, rol kanë dhe institucione të tjera shtetërore, si: Instituti i Arkeologjisë, protokolli i bashkëpunimit të të cilit me fondacionit të posaçëm është aneks i marrëveshjes së administrimit. Nga ministritë e tjera, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka rol parësor në zbatim, si ministria e cila ka në fushë përgjegjësie zonat e mbrojtura mjedisore, siç është rasti i parkut kombëtar të butrintit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për sa i përket transfertës fillestare të shumës nga llogaria aktuale e ZAKPA-së Butrint te fondacioni i posaçëm, dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lidhur me infrastrukturën mbështetëse.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Procesi i negociimit të marrëveshjes së administrimit është ndjekur nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr.308, date 20.9.2020, të ministrit të Kulturës. Ky grup ka negociuar me përfaqësuesit e fondacionit të posaçëm, të cilët janë caktuar me vendim të bordit të drejtorëve të këtij të fundit.

XI. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Sipas marrëveshjes së administrimit, fondacionit të posaçëm do t'i transferohet shuma financiare e gjendjes së llogarisë të ZAKPA-së Butrint në datën e transferimit, ndërkohë edhe AADF-ja do të kontribuojë me një grant kundrejt fondacionit të posaçëm.

Vlera e financimit nëpërmjet grantit të AADF-së do të jetë deri në vlerën katër milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë dollarë (4,985,000 \$), ndërsa vlera e saktë e fondeve të papërdorura dhe të mbartura të administruara/kontabilizuara nga ZAKPA-ja Butrint do të përcaktohet në datën e transferimit.

Ka rëndësi të theksohet se fondet e ZAKPA-së Butrint, edhe pse pjesë e fondeve publike të buxhetit të shtetit, administrohen sipas rregullave të veçanta, sipas vendimit nr.928, datë 28.12.2011, të Këshillit të Ministrave. Bazuar në këtë vendim, ato konsiderohen si të ardhura jashtë limitit.

Disbursimi nga të dyja palët fillon pas transferimit të pasurisë kulturore në datën e transferimit, në vlera ekuivalente, dhe pjesa e mbetur do të disbursohet në vijim të kërkesave për fonde të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, bazuar në nevojat e tij dhe në përputhje me planin e biznesit.

KËSHILLI I MINISTRAVE